



Republika e Kosovës
Prizrenit
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediyesi



Komuna e
Opština Prizren – Prizren

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

KK Prizren (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Ofruesi i Shërbimeve" **NSH "Smart Architecture"**

ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Hartimi i projektit detal për rregullimin e infrastrukturës si dhe renovimin e objektit të Stacioni i Autobusave në Prizren me numër identifikues: Nr. pro. 622-24-6372-2-1-3

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve: *[shëno përshkrimin e përgjithshëm të shërbimeve]*, përshkrimi i përgjithshëm i shërbimeve, është dhënë në specifikacion që është aneks i kontratës

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë : **179,950.00 € (njëqind e shtatëdhjetë e nënt mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro)**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit]*.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontratë" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit


duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **[angleze][shqipe][serbe]**² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për

Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	09.09.2024
Vula:	

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Z. Shaqir Totaj Kryetar
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	12.09.2024
Vula:	

Për operatorin ekonomik

Emri:	Valon Elshani
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	15.09.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/ Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Emri i Autoritetit Kontraktues	1.1	KK Prizren
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	1.2	"Ofruesi i Shërbimeve" NSH "Smart Architecture"
Titulli i kontratës dhe Numri i prokurimit	1.3	Hartimi i projektit detal për rregullimin e infrastrukturës si dhe renovimin e objektit të Stacioni i Autobusave në Prizren me numër identifikues: Nr. pro. 622-24-6372-2-1-3
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha.	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. Gjuha e përdorur do të jetë :gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës për një periudhë prej 7 muaj kalendarik
Sigurimi	10.1	
Programi i ekzekutimit	11	Plani dinamik për realizimin e projektit do të jetë 6 muaj kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<i>Të gjitha obligimet tatimore dhe doganore i bartë Operatori ekonomik.</i>
Patentat dhe licencat	13.1	Sipas specifikacionit të tenderit
Cilësia e shërbimit	18.2	Sipas kërkesës në specifikacion (paramas)
Pagesa	20.1	Pagesat do të bëhen në kiste
Çmimi	21.3	179,950.00 € (njëqind e shtatëdhjetë e nënt mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro)
Ndryshim të çmimit	24.1	Nuk do të ketë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	25.1	kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Do të bëhet ndërmjet drejtorit të projektit dhe operatorit ekonomik
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. Gjuha e përdorur do të jetë :gjuha shqipe
Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të projekti	32.2	Qelë Lamaj Drejtor në DSHP
Menaxher i projektit	33	Muhamet Bajrami IDA në DSHP
Personi përgjegjës për pranimin e shërbimit-organi mbikqyrës	34	Organi mbikqyrës



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Shërbime Publike, ([tel:038-200 44751](tel:038-20044751)), , 5 shkurt , 2024

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

KONKURS PROJEKTIMI

Për

DETYREN PROJEKTUESE

**A - RIKONSTRUKTIMI, TRANSFORMIMI DHE MODERNIZIMI I
ZONËS SË STACIONIT TË AUTOBUSËVE NË PRIZREN**

**B - NDËRTIMI I STACIONIT DHE PARKINGUT NËN-TOKËSOR
NE HAPESIREN TE STACIONI I AUTOBUSEVE**

I. HYRJE

Komuna e Prizrenit ka planifikuar një projekt të gjërë për rikonstruktimin dhe modernizimin e stacionit të autobusëve, përfshirë ndërtimin e një parkingu të madh nëntokësor. Synimi i këtij projekti është të kthejë këtë zonë në një ambient modern dhe të përshtatshëm për qytetarët, shfrytëzuesit dhe vizitorët.

II. KONTESTI URBAN

Stacioni i autobusëve është ndërtuar në vite '80 dhe ka një pozicion shumë të rëndësishëm në qytet, megjithëse përballlet me një trafik të dendur në këtë zonë. Duke e konsideruar rëndësinë e tij në transportin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, Komuna e Prizrenit ka vendosur ta modernizojë atë për të krijuar një hyrje të përshtatshme në qytet.



Kopja e planit te stacionit te autobuseve



Lokacionet e mundshme per parkingjun nentokesor (projektanti duhet vet ti gjej opcionet e mundshme).

III. FUNKSIONIMI AKTUAL I STACIONIT TË AUTOBUSËVE

Stacioni aktual i autobusëve ofron shërbime të ndryshme:

1. **Shërbime për autobusët:**
 - Ardhja dhe nisja e rreth 21 autobusëve.
 - Parking për 20 autobusë.
2. **Zona e parkingut:**
 - Zonë e vogël parking për taksitë.
 - Zonë e vogël parking për qytetarët.
3. **Shërbimet shtesë:**
 - Shërbime biletash për pasagjerët.
 - Shërbime postare për nevojat postale.
4. **Bizneset në hapsirat e stacionit:**
 - Disa biznese të vendosura në zonën e stacionit.
5. **Hapsirat e pashfrytëzuara:**
 - Restorant i madh.
 - Kuzhinë.
 - Pjesë e hollit
 - Sportelet e biletave

IV. KONTESTI I PROJEKTIT

Projekti do të përqendrohet në dy pika kryesore:

1. **Rikonstruktimi dhe Transformimi i Stacionit:**
 - Modernizimi dhe rifunksionalizimi i strukturave ekzistuese të stacionit.
 - Zhvillimi i një plani funksional për përdorimin e përshtatshëm të hapësirave të stacionit.
 - Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese si sportelet e biletave dhe posta.
 - Ndërtimi i një zone të re për tregti dhe shërbime, përfshirë restorantin dhe hapësirat komerciale të tjera.
 - Përmirësimi i hapësirave të pashfrytëzuara dhe rikonceptimi i tyre për shfrytëzim efikas.
2. **Një Parking Nën-Tokësor i Madh:**
 - Projektimi i një parkingu të rehatshëm dhe të sigurt nëntokësor.
 - Strukturë me dy nivele me kapacitet për 700-800 automjete.
 - Përmbajtje e plotë e nevojave të përdoruesve përfshirë rrugët e hyrjes-daljes, ashensore, dhe shkallë antizjarrë.
 - Sigurimi i një organizimi të përshtatshëm dhe të sigurt të hapësirave për parkim.

V. PROGRAMI I RI I STACIONIT TË AUTOBUSËVE

Programi i ri për stacionin përfshin:

1. Rikonceptimi dhe Përdorimi i Hapësirave:

- Modernizimi i sporteleve dhe hapësirave të shërbimeve ekzistuese.
- Përshtatja e kuzhinës dhe restorantit ekzistues për nevojat e reja.
- Zhvillimi i një zone të përbashkët për tregti dhe shërbime.

2. Administrata dhe Zyra e Informacionit:

- Kthinat e administratës përfshijnë hapësira të përshtatshme për zyrat dhe dherat e administratës, përfshirë dhe një zyrë të posaçme për informacionin dhe dërgesat.

3. Rikonceptimi dhe Përdorimi i Hapësirave të Pashfrytëzuara:

- Përshtatja e hapësirave të lira për përdorim të efikashtë dhe të përshtatshëm.
- Ndërtimi i një hapësire të re për tregti dhe shërbime të reja.

VI. PROGRAMI I PARKINGUT NËN-TOKËSOR:

- Struktura e parkimit do të përfshijë rrugë hyrëse, rrugë dalëse, shkallë antizjarrë dhe ashensore për sigurinë e përdoruesve.
- Organizimi i hapësirës për parkim do të jetë i sigurt dhe efikas, duke ofruar përdoruesve një ambient të rehatshëm.

VII. PËRMBAJTJA SIPAS HARTËS ZONALE

Projekti do të koordinohet me hartën zonale dhe do të respektojë klasifikimin si zonë e shërbimeve sipas dokumentacionit të përcaktuar nga Komuna. Në dokumentin e hartave zonale kjo zonë nuk shtjellohet në detale specifike për një institucion si stacioni i autobusëve. Okupimi më i pëtafërt për të cilin jepen detalet obligativisht është ZSH – Infrastruktura e Institucioneve Administrative: ISN është 2.0. Lartësia mbi tokë dhe nën tokë nuk është e përcaktuar nga Harta Zonale.

Parcelat në Veri nr. 7095 – 7096 – 7097 janë Brenda ZB – 3 (Zona e Banimi – 3). Këtu ISN është 3.0. Lartësia e ndërtimit 30.2 me 9 kate.

Zona posedon vijat ndërtimore anash rrugëve të projektuara dhe atyre ekzistues

VIII. PIKAT E DOMOSDOSHME QE DUHET TE INKUADROHEN NE PROJEKT

Nr.	Pikat e domosdoshme në Projekt	Përshkrimi
1	Shenjëzimi i tabelave informative "Stacioni i Autobusëve" në tre gjuhë.	Përfshin shënjestrimin e tabelave informative në gjuhën shqipe, turke dhe serbe për përdoruesit e ndryshëm.
2	Ngastra kadastrale e stacionit të autobusëve duhet të rrethohet me një gardh modern.	Planifikimi dhe ndërtimi i një gardhi modern për sigurinë dhe integritetin e ngastrës kadastrale.
3	Dy laura (rampa) për hyrje dhe dalje që janë nën kontroll.	Identifikimi dhe planifikimi i dy laurave me kontroll të lartë për hyrje dhe dalje të autobusëve.

4	Sistemi i kamerave duhet të jetë i instaluar.	Projektimi dhe instalimi i një sistemi kameral për mbikëqyrje të sigurtë të zonës.
5	Planifikimi i 15 peronave për transport lokal dhe 7 peronave për transport ndërkombëtar.	Krijimi dhe organizimi i 15 peronave për transport lokal dhe 7 për transport ndërkombëtar.
6	Hapësira e mjaftueshme (22) për autobusë në pritje.	Përcaktimi dhe organizimi i hapësirave të mjaftueshme për pritjen e autobusëve.
7	Planifikimi i infrastrukturës së ndriçimit brenda dhe jashtë objektit.	Projektimi i një infrastrukture të ndriçimit efikase dhe të sigurt brenda dhe jashtë stacionit.
8	Hapësira e mjaftueshme për lëvizjen e autobusëve, me sinjalizim vertikal dhe horizontal.	Planifikimi i hapësirave për lëvizjen e sigurtë të autobusëve me sinjalizim të qartë.
9	Hapësira e ndarë për lëvizjen e udhëtarëve nga autobusët me siguri të plotë.	Identifikimi dhe organizimi i hapësirave të ndara për lëvizjen e udhëtarëve me siguri të plotë.
10	Hapësira e ndarë për lëvizjen e veturave dhe taksive private nga autobusët.	Përcaktimi dhe organizimi i hapësirave të ndara për lëvizjen e veturave dhe taksive private.
11	Parking për autotaksitë e ndara nga lëvizjet e autobusëve.	Planifikimi i një parkingu të veçantë për autotaksitë që është i ndarë nga lëvizjet e autobusëve.
12	Qasja në transportin urban, me një stacion sa më pranë stacionit të autobusëve.	Përcaktimi dhe organizimi i një qasjeje të lehtë dhe të rehatshme në transportin urban pranë stacionit.
13	Hapësira për parkimin e bicikletave.	Planifikimi i një hapësire të dedikuar për parkimin e bicikletave me infrastrukturë të përshtatshme.
14	Sistemi i informimit me ekrana për transportin urban, ndërkombëtar dhe lokal.	Projektimi dhe instalimi i një sistemi informimi me ekrana për shërbimet e transportit.
15	Tabelat e lexueshme elektronike për oraret e udhëtimit dhe informacionin e peronit.	Krijimi dhe vendosja e tabelave lexueshe elektronike për informimin e udhëtarëve.
16	Pikë informuese e pajisur me autoparlant të zëshëm për informimin e udhëtarëve.	Krijimi i një pike informuese me autoparlant për informimin e udhëtarëve për nisje dhe relacione.
17	Pikë informuese me adresa publike për informimin e udhëtarëve.	Vendosja e pikës informuese me adresa publike për shërbimin e udhëtarëve.
18	Së paku 6 sportele për shitjen e biletave.	Identifikimi dhe vendosja e së paku 6 sporteleve për shitjen e biletave.
19	Hapësira e brendshme për pritjen e udhëtarëve, e klimatizuar.	Projektimi dhe organizimi i një hapësire të brendshme të klimatizuar për pritjen e udhëtarëve.
20	Së paku 2x4 WC për meshkuj dhe femra, me të gjitha standardet dhe pajisjet përcjellëse dhe ujë të nxehtë.	Planifikimi dhe vendosja e së paku 2x4 WC për meshkuj dhe femra, me standarde dhe pajisje të plotë.
21	Një dhomë e ndarë për nënën dhe fëmijën me banjo me dhe të gjitha elementët përcjellëse.	Krijimi dhe organizimi i një dhomë të posaçme për nënën dhe fëmijën me banjome dhe përcjellëse të nevojshme.

22	Dhoma për pranimin dhe sigurimin e bagazheve.	Identifikimi dhe planifikimi i një dhome për pranimin dhe sigurimin e bagazheve.
23	Kushte të mira higjienike.	Përcaktimi dhe sigurimi i kushteve të mira higjienike në tërë objektin.
24	Së paku 2 kabina për telefonat publike.	Identifikimi dhe vendosja e së paku 2 kabinave për telefonat publike.
25	Qasje për persona me aftësi të kufizuara.	Planifikimi dhe organizimi i një qasjeje të përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara.
26	Orë të vendosura në pozita kyçe.	Vendosja e orëve në pozita kyçe për lehtësimin e orientimit të udhëtarëve.

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT IDEOR (PROGRAMI)

Projekti i modernizimit dhe ringjalljes së Zonës së Stacionit të Autobusëve në Prizren përfshin dy pika kryesore:

A. STACIONI I AUTOBUSEVE: REHABILITIM, RESTAURIM, DHE MODERNIZIM I NDËRTESES EKZISTUESE

1. Objektiv i Projektit:

- Rehabilitimi dhe modernizimi i Stacionit të Autobusëve, duke përfshirë ndërtesën ekzistuese nga vite të 80-it. Ruajtja e vlerave arkitektonike si një aset i rëndësishëm i trashëgimisë nga periudha socialiste.

2. Siperfaqja e Përafërt (S): 4000m²

- Kujdes i veçantë për përdorimin e hapsirave për të ofruar komoditet, sistematizim dhe rekreacion për shfrytëzuesit.

3. Renovimi dhe Ripërdorimi:

- Renovimi i të gjitha pjesëve të objektit duke ruajtur mobiljet origjinale.
- Intervenime të bëra nga brenda dhe jashtë për të ruajtur origjinalitetin.

4. Racionalizimi i Hapesirave për Ardhje-Nisje të Autobusëve (22 autobusë):

- Përafërtia e Hapesirave $S=1500m^2$.
- Konservimi, rinovimi, ose rindërtimi i mbulesave të peroneve ekzistuese.

5. Vendoajet e Parkingjeve të Reja dhe Zona për Qytetarët:

- Parking për 22 autobusë në vendin e nisjes ($S=2000m^2$).
- Zhvillimi i një parkingu për qytetarë me vende për vetura, taksi dhe bicikleta ($S=600m^2$).
- Pjesa e siperfaqes duhet të jetë gjelbër, duke përfshirë drunjët me lartësi të madhe.

6. Intervenime të Reja Arkitektonike:

- Propozime për zgjidhje arkitektonike në zonat publike, përpara peroneve, hol dhe sportelet, restorantin dhe hapesirat tjera komerciale, si dhe administratën e re.

7. Instalimet:

- Përfshirja e instalimeve të reja për ujë, energji elektrike, ajrosje, ngrohje dhe ftohje.

8. Kontroll Struktural:

- Parashikimi i një kontrolli struktural për ndërtesën ekzistuese për të garantuar sigurinë dhe përmbushjen e kërkesave aktuale.

B. PROJEKTI I PARKINGUT NENTOKESOR

1. Objektiv i Projektit:

- Ndërtimi i një parkingu nentokesor për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurinë e zonës.
2. **Sipërfaqja e Përafërt (S):**
- Përafërtia e plotë e parkimit duhet të mbulojë nevojat për të siguruar vendparkim për vizitorët dhe shfrytëzuesit e stacionit.
3. **Integrimi me Zonën Ekzistuese:**
- Planifikimi i integruar me zonën ekzistuese të stacionit dhe përdorimi i teknologjive moderne për të garantuar sigurinë dhe lehtësimin e lëvizjes.
4. **Hapësirat Gjelbra dhe Mbrojtja e Mjedisit:**
- Përfshirja e sipërfaqeve të gjelbra dhe masave për mbrojtjen e mjedisit, duke inkorporuar elemente të përshtatshme mjedisore.

PROGRAMI I REHABILITIMIT TË STACIONIT TË AUTOBUSEVE - SIPËRFAQET AKTUALE

Sipërfaqet aktuale të stacionit janë si vijon:

Nr.	Hapesira	Sipërfaqja (m ²)
1	Bodrumi	255
2	Perdhesa	1237
3	Perdhesa Sekondare	833
4	Kati Kryesor	938
5	Kati Sekondar	488
6	Gjithsej	3700

PJESA E JASHTME TË STACIONIT TË AUTOBUSËVE

Nr.	Hapësira	Planifikimi dhe Përmirësimet
1	Ndërtesa e Ngrohtorës dhe e Larjes së Autobusëve	- Zhvillimi i planifikimit të përshtatshëm për hapësirën e ngrohtorës dhe të larjes së autobusëve për të siguruar efikasitet maksimal dhe lehtësi në manovrim.
2	Rezervoari i Karburanteve	- Sigurimi i infrastrukturës së sigurt dhe të përshtatshme për ruajtjen dhe administratën e karburanteve, duke i përmbyshur të gjitha standardet dhe masat e sigurisë.
3	Peronat e Nisjes (22)	- Rikonceptimi i peronave të nisjes për të akomoduar 22 autobusë, duke ofruar organizim optimal dhe shërbime shtesë për udhëtarët.
4	Parkingu i Autobusëve (22 Vende)	- Përditësimi i dizajnit të parkimit për të siguruar një përdorim më të lehtë dhe të qëndrueshëm të hapësirës, përfshirë elementët e sigurisë dhe të komoditetit.
5	Parku i Stacionit	- Planifikimi i një parku tërheqës dhe funksional që ofron ambient rekreativ për udhëtarët dhe komunitetin.
6	Parkingu i Taksive dhe i Veturave	- Organizimi i hapësirës së parkimit për taksitë dhe makinat private për të siguruar një rrugë qarkullimi efikase dhe të përshtatshme.

PROGRAMI EKZISTUES I KTHINAVE TË STACIONIT TË AUTOBUSEVE :

Projekti ideor synon të përfshijë një analizë të hollësishme të funksioneve ekzistuese në stacionin e autobusëve dhe të riprogramojë ato për të përmirësuar efikasitetin dhe për të ofruar shërbime të avancuara për përdoruesit

Perdhesa:

Nr.	Hapësira	Sipërfaqja Ekzistuese (m ²)
1	Hyrja	15
2	Shkallet kryesore	28
3	Agjencionet turistike	16
4	Agjencionet turistike (riprogramuar)	16
5	Frizer (riprogramuar)	36
6	Garderoba	26
7	Erembrojtes	7
8	Pritja per nena me femije	36
9	Holli kryesor	524
10	Biletaria	51
11	Sherbimet mjeksore	6
12	Sherbimi I sigurise	5
13	Pasazh	-
14	Recepioni I hotelit	25
15	Depo	24
16	Hall	30
17	Garderoba per meshkuj me banjo	14
18	Garderoba per femra me banjo	14
19	Shitore	90
20	Embeltore	35
21	Recepioni I hotelit (riprogramuar)	22
22	Shitore suvenira	34
23	Depo	33
24	Shitore e autopjeseve	72
25	Banjo	13
26	Holl	16
27	Hyrja	5
28	Shkallet e hotelit	-
29	Zyre	52
30	Vozitesit (pushim dhe banjo)	20

POSTA PERDHESE:

Nr.	Hapësira	Sipërfaqja Ekzistuese (m ²)
1	Hyrja	5

2	Holli	21
3	WC	4
4	Depo	25
5	Depo	26
6	Sportelet	54
7	Zyre	17
8	Telefonat	12
9	Zyre	18
10	Zyre	18
11	Salla e mbledhjeve	33
12	Koridori	11
Gjithsejt perdhesa dhe posta perdhese		1237 m ²

KATI:

Nr.	Hapësira	Sipërfaqja (m ²)
10	Restorani i Hotelit	24
11	Garderoba	13
12-17	Banjo e Restorantit (12-17)	26
18	Shkallet kryesore	22
19	Kafe e Restorantit	325
22	Kuzhina	136
23	Shkallet e Kuzhines	7
24	Ashensori i Kuzhines	4.46
25	Zyre	15
26	Salle mbledhjesh	50
27	Zyre	20
28	Zyre	20
29	Korridor	11
30	Holli	10
31	Shkallet e Hotelit	9
32	Minikuzhina e Restorantit te Hotelit	11
34	Dhoma e Lajmerimit	4.28
		871
	Gjithsej kati	871

HOTELI (aktualisht administrata):

Nr.	Hapësira	Sipërfaqja (m ²)
1-14	Dhoma secila	20
2	Koridori	80
3	Holli I hyrjes	30
4	Shkallet	12
5	Restoranti I hotelit	16
	Gjithsej bruto	487

BODRUMI:

Nr.	Hapësira	Sipërfaqja (m ²)
-	Zona e bankove publike	165
-	Zona nen kuzhine	90
	Gjithsej bodrumi	255

PROGRAMI I RI I CILI DUHET TE INKUADROHET NE PROJEKTIN E RI**Administrata:**

Administrata duhet të zëvendësojë sipërfaqen e hotelit.

Kërkesat për administratë janë:

- Zyra individuale 10 – 12, me sipërfaqe 12 – 20 m².
- Zyra dyshë 3 – 4, me sipërfaqe 12 – 20 m².
- Zyra treshë 1, me sipërfaqe 12 – 20 m².
- Një sallë e mbledhjes me sipërfaqe 30 m².
- Kthina e sigurisë dhe e vëzhgimit me kamera.
- Dhome IT.

Lista e Kritereve për Autorizim:

- Duhet të plotësohet imperativisht lista e kritereve të domosdoshme për autorizim nga drejtoria e shërbimeve publike – Komuna e Prizrenit.

Projekti Ideor:

- Projekti ideor mund të sjellë propozime të reja rreth funksioneve të vjetra që nuk janë më aktuale.

PARKINGU NENTOKESOR

Sipërfaqja e Përafërt:

- $S \approx 20,000 \text{ m}^2$ (2 x 10000 m^2)

Projektimi:

- Projekti synon një parking të madh nentokesor për 700 – 800 vetura me pagesë. Për të paktën 50%, do të shfrytëzohen për qytetarë – vizitorë që do të përdorin trafikun urban.
- Parkingu mund të ketë dy nivele në nentokë. Rampa e hyrje-daljeve duhet të realizohet nga njëra nga rrugët ekzistuese, ndërsa rampat mund të vendosen edhe në vende të ndryshme.

Infrastruktura:

- Parkingu duhet të ketë të paktën 4 nyje me ashensore dhe shkallë antizjarr.
- Një banjo publike për të gjithë vizitorët e stacionit: 5 WC + 5 pisoare për meshkuj dhe 10 WC për femra. Për secilën gjini, një zonë tamponi me 6 lavamana.

Sipërfaqja Teknike:

- Sipërfaqja teknike duhet të jetë 50 m^2 dhe do të përdoret për mirembajtje dhe aspekte teknike të parkingut.

LISTA INDIKATIVE E SIPERFAQEVE

A- STACIONI

nr.	Sipërfaqet e destinuara	Sipërfaqja (m ²)	Indikatori dhe Veprimet
1	Stacioni ekzistues (ndertesa kryesore)	4000	
2	Hapesirat e jashtme për ardhje-nisje të autobuseve (22 autobuse)	1500	
3	Parkingjet e reja për 22 autobuse	2000	
4	Parkingu në sipërfaqe për qytetarë, maksimumi 30 min për rreth 20 vetura, 10 vende për taxi, 100 vende për biçikleta	600	
5	Sipërfaqet e jashtme për gjelberim Sipërfaqja minimale	5000	
	Gjithsej	13100	

B – PARKINGU NENTOKESOR

nr.	Siperfaqet e destinuara	Siperfaqja (m2)	Indikatori dhe Veprimet
1	Parkingu i madh netokesor per 800 – 1000 vetura me pagese	20000	

1) PROJEKTET

Projekti IDEOR Permbajtja

PJESA GRAFIKE PËR PROJEKT IDEOR

Prezantimi i projektit të jetë sa më i lexueshëm dhe të jetë i palosur në format A4.

Pjesë të prezantimit duhet të jenë:

1. Projektet duhet të realizohen veçmas për:

A - Rehabilitimi, renovimi, modernizimi i objektit te stacionit të autobuseve

B - Parkingu nentokesor

A - Rehabilitimi, renovimi, modernizimi i objektit te stacionit të autobuseve:

1. Pershkrimi i vizionit per gjendjen ekzistuese dhe zgjidhjen e propozuar – obligative incizimi dhe fotografimi i lokacionit.
2. Incizimi i gjendjes ekzistuese ne shkalle 1:200
3. Zgjidhja arkitektonike e gjendjes ekzistuese ne shkalle 1:200
4. Situacioni i te gjitha etazheve të objektit me permbajtje te gjendjes ekzistuese 1:200
5. Situacioni i te gjitha etazheve të objektit me permbajtje te gjendjes se propozuar ne shkalle 1:100
6. Situacioni i hapësirës së jashtme, gjendja ekzistuese dhe organizimi i ri i propozuar ne shkalle 1:500
7. Zgjidhja e oborrit te stacionit me organizimin e vendosjes se peroneve, linjave te autobusëve, parkingut, gjelbërimit, parkingut per Taxi, komplet infrastruktura e jashtme.
2. Prerjet terthore karakteristike ne shkalle 1:50 (dy prerje karakteristike)
8. Pamje 3 D, te objektit, brenda dhe jashte, se bashku me hapësirën përreth.
9. Paramasa dhe parallogari e përafërt e koston për realizimin e projektit

B - Parkingu nentokesor

1. Pershkrimi i vizionit per gjendjen ekzistuese dhe zgjidhjen e propozuar, duke perfrfshire kapacitetin, funksionimin dhe perfitimin nga ky parking.
2. Situacioni i niveleve te propozuara te parkingut nentokesor, propozuar ne shkalle 1: 500, me zgjidhjen dhe levizjen e korsive te parkingut te organizuar.
3. Zgjidhja e oborrit te stacionit me organizimin e vendosjes se peroneve, linjave te autobusëve, parkingut, gjelbërimit, parkingut per Taxi, komplet infrastruktura e jashtme, me infrastrukturen e jashtme 1:500

4. Zgjidhja e hyrjeve daljeve ne parkingun nentokesor te propozuara ne raport me infrastrukturen e jashtme 1:500
5. Prerjet terthore karakteristike ne shkalle 1:500 (dy prerje karakteristike)
6. Pamje 3 D, te objektit, brenda dhe jashte, se bashku me hapesiren perreth.
7. Paramasa dhe parallogari e përafërt e kostos për realizimin e parkingut nentokesor

2) PROJEKTET

Projekti DETAL Permbajtja

PJESA GRAFIKE PËR PROJEKT detal

Në kuadër të ndërtimit të stacionit të autobusëve dhe parkingut nëntokësor, është e rëndësishme të pasqyrohen të dhënat në projektin kryesor te detajuar sipas standardeve BE-së per projektit te detajuar arkitektonik, dhe të ndërtohet një strategji e plotë për zhvillimin e projektit. Këtu janë disa hapa dhe komponentë që mund të përfshihen në një projekt të tillë:

1. Analiza e Lokacionit:
 - Identifikimi i lokacionit, incizimi gjeodezik, incizimi i rrjetit te kanalizimit, ujesjellesit, rrjetit elektrik,(obligative tem err shenime nga KEDS, Hidroregjioni Jugor, PTK etj...), cdo elementi qe eshte pjese kesaj hapesire duke u paraqitur si gjendje ekzistuese dhe gjendja e propozuar,
 - Analiza e infrastrukturës se jashtme e gjendjes ekzistuese , paraqitja e levizshmerise se autobuseve, kapaciteti ekzistues, analiza e peroneve, mearilizimi, funksionimi actual
2. Projekti për Secilin Lokacion:
 - Përcaktimi i një projekt të veçantë për secilin lokacion, duke përfshirë ndërtimin e stacionit, hapësirat përreth, peronat, dhe sistemin e parkingut nëntokësor.
3. Gjendja Ekzistuese dhe Propozimi i Ri:
 - Paraqitja e gjendjes ekzistuese dhe paraqitja e projektit propozuar, duke përfshirë ndërhyrjet arkitektonike dhe planimetritë e nevojshme.
4. Funksionaliteti dhe Shfrytëzimi i Hapësirës:
 - Hartimi një projekt funksional që përcakton se si do të shfrytëzohet hapësira, duke përfshirë zonat për shërbimin e pasagjerëve, zona për operacionet e autobusëve, dhe parkingun nëntokësor.
 - Qasjet dhe infrastruktura në lokacion
 - Topografia e lokacionit
5. Ilustrime dhe Pamje 3D:
 - Zhvillimi ilustrime dhe pamje 3D të objektit, parkingut dhe hapësirën për të përfshirë një pamje të qartë dhe realiste të dizajnit të ndërtuar.
6. Mobilje Urbane dhe Përdorimi i Materialeve:
 - Specifikimi I dizajnit të mobiljeve urbane dhe përdorimin e materialeve për të siguruar një përshtatje me identitetin e objektit ekzistues, duke mos e nderruar permbajtjen dhe destinimin e arsyeshmerine dhe duke e përmirësuar përdorueshmërinë.

7. Sistemi i Ndrëimit Publik dhe Kanalizimi Kabllor:
 - Përcaktimi sistemin e ndrëimit publik dhe kanalizimin kabllor për të siguruar siguri dhe funksionalitet në këtë hapësirë.
8. Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal:
 - Një projekt detal të sinjalizimit horizontal dhe vertikal për të udhëzuar përdoruesit brenda dhe jashtë hapësirës.
9. Mjedisi dhe Qëndrueshmëria:
 - Ndikimi mjedisor dhe strategjia për të siguruar që ndërtimi të jetë i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm për mjedisin.
10. Dorëzimi i Projektit dhe Prezantimi Publik:
 - Dorëzimin final të projektit në 5 kopje fizike (duke përfshirë dorëzimin e draft projekteve sa herë që kerkohen nga kkomuna derisa të vë në formë finale), veqmas të cilat shërbejnë për analizë dhe CD, duke treguar gatishmërinë për prezantim publik në çdo rast.
11. Planifikimi financiar :
 - Hartimi i një plani financiar të detajuar dhe buxhetor për të realizuar ekzekutimin e projekteve.
12. Fazat e Implementimit
 - Projektanti paraqet zgjidhjet për të gjitha fazat gjatë ndërtimit, përfshirë zgjidhjet alternative për parkingun, linjat e autobusëve, funksionalitetin e zyrave, sportelet, pritjet për udhëtarët, etj.
 - Paraqitja e planit të funksionalitetit gjatë fazave të ndërtimit - në formë tekstuale dhe me të gjitha situacionet gjatë fazës së ndërtimit.

KRITERET

DIZAJNI (70%)

1. Koncepti më i mirë dhe i pranueshëm për Pikën A
2. Koncepti më i mirë dhe i pranueshëm për pikën B
3. Koncepti më i mirë i ndërlidhjeve të pikës A dhe B
4. Koncepti i çdo linje të autobusëve – fillimi dhe mbarimi
5. Zgjidhja arkitektonike e platformës kryesore me hyrje dhe dalje të autobusëve
6. Zgjidhja arkitektonike e parkingut
7. Zgjidhja arkitektonike e hyrjes dhe daljes nga parkingu nëntokësor
8. Kyqjet në peron dhe dalje nga peroni
9. Sigurimi i një qasje të lehtë dhe të sigurt për pasagjerët. Kjo përfshin infrastrukturën për përshpejtimin e ngritjes dhe zbritjes së pasagjerëve, informacionin e qartë për rrugën e autobusit dhe ndihmë për personat me aftësi të kufizuara.
10. Zgjidhja dhe përfshirja e çdo teknologjie për informacionet e peroneve, për pasagjerë për parking, oraret etj....
11. Situacionet e objektit të stacionit me të gjitha etazhet dhe përshkrimet e të gjitha hapësirave dhe destinimi të tyre
12. Koncepti i parkingut të stacionit me të gjitha etazhet dhe konceptet e tyre.

13. Levizja e automjeteve ne parkingun nentokesor dhe te gjitha parkingjet me numra dhe shenjezim i tyre.

EKONOMIKE (20 %)

1. Projekti duhet të ketë nivelin e arsyeshëm të koston dhe mundësinë e përcaktimit per prioritetin e përdorimit të materialeve vendore.
2. Projekti duhet të ketë mundësinë e rritjes ekonomike që e përcjell transformimin e lokacionit.
3. Projekti duhet të përfshijë zhvillimin e bizneseve, që mund të rrisë investimet publike.
4. Teknologjia e përzgjedhur duhet të ketë kosto efektive.
5. Autobuset, parkingu, Taxi, dhe shërbimet tjera duhet të kenë kushte shume te mira të operimit (qarkullimit)

SOCIALE DHE MJEDISORE (10%)

1. Projekti duhet të ndërlidhë në mënyrë të efektshme hyrjet dhe daljet e te gjithë shfrytezuesve.
2. Projekti duhet të krijoj hapësira të ndryshme publike për të gjithë kategorite dhe shfrytezuesit
3. Zhvillimi i pjesës se projektit duhet të ketë shumëllojshmëri sociale
4. Qasja per persona me aftesi te kufizuar ne qdo cep te objektit, infrastruktures se jashtme dhe parkingut
5. Projekti duhet të ketë efikasitet energjetik: Ndriçim natyror dhe menaxhim të temperaturave.
6. Projekti duhet të ketë efektivitet në furnizimin me ujë: Përdorimi i ujërave të shiut për ujitjen e zonave të gjelbëruara etj.
7. Projekti duhet të ketë bio-diversitet: të krijoj biotipe për lloje të ndryshme të hapësirave te gjelbra dhe llojeve te bimesise, (te karakterit lokal).
8. Projekti duhet të ketë emetim të ulët: Zhurmë të ulët, ndotje të ulët të ajrit, ndotje të ulët të ujit, etj.

PJESA III. OFERTA FINANCIARE¹

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i konkursit të projektimit: **Hartimi i projektit detal për rregullimin e infrastrukturës si dhe renovimin e objektit të Stacioni i Autobusave në Prizren**

Zonja/Zotërinjë

1. Ne, të nënshkruarit, ofrojmë që të dorëzojmë projektimin e detajuar inxhinierik për konkursin e projektimit të lartë cekur në pajtim me Dosjen e juaj të Konkursit të Projektimit Nr. **622-24-6372-2-1-3** dhe Koncept Propozimin.

2. Propozimi jonë Financiar për projektimin e radhës (projektimin e detajuar inxhinierik) është në shumë prej: Çmimi total i tenderit është: me shifra: **179,950.00 €**

[shëno çmimin e tenderit në fjalë: Njeqinde e shtatë mijë e nentëqinde e pesëdhjetë Euro]

3. [Nëse koncept projekti jonë fiton për fazën e radhës së projektimit, ne marrim përsipër të bëjmë nënshkrim të kontratës dhe të dorëzojmë "projektimin e detajuar inxhinierik" brenda [shëno numrin e ditëve] **180** pas nënshkrimit të kontratës.

4. Operatori Ekonomik [dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: [shëno nacionalitetin]

5. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formë tjetër.

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

6. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	N.SH "Smart Architecture"(Valon Elshani B.I.)

¹ Aplikohet vetëm në rast të kontratës për shërbime pas konkursit që do ti jepet fituesit apo njërit nga fituesit e konkursit

PJESA II: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË

Emri	N.SH "SMART ARCHITECTURE"
Adresa	Rr. "J.Gervalla" pn
Qyteti	Prizren
Kodi Postar	20000
Kontakti	Valon ELSHANI
Telefoni	049121565
Fax	/
E-mail	nsh.smartarchitect@gmail.com
Numri i TVSH	330261298

BANKA

Emri	NLB Banka
Adresa	Prishtinë
Qyteti	Prizren
Kodi Postar	20000
Shteti	Kosovë
Llogaria Bankare	1705001012571374
IBAN (opcionale)	/
BIC (Opcionale)	/

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)

DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)

11.07.2024





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **130920**

Për **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Valon Elshani B.I. (N.SH. Smart Architecture)**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Hartimi i projektit detal për rregullimin e infrastrukturës si dhe renovimin e objektit të Stacioni i Autobusave në Prizren.**

Nr. prokurimit: 622-24-6372-2-1-3 , Nr. brendshëm: 622-24-017-213

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **17,995.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërës nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **17,995.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 212 ditë kalendarike prej **13.09.2024** deri më **13.04.2025**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 13.09.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112: Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **130920**

Kontraktuesi

Emri	Valon Elshani B.I. (N.SH. Smart Architecture)
Përfaqësuar nga	Valon Elshani
Adresa	JUSUF GËRVALLA PN.
Nr i Biznesit	811004994
Telefoni	049121565

Përfituesi

Emri	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
Adresa	PRIZREN

Garantuesi

Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB

Mbulueshmëria e Polices

Shuma Siguruar	17,995.00
Periudha Sigurimit	13.09.2024 - 13.04.2025
Primi	323.91
Tvsh	58.30
Primi Bruto	382.21
Data e lëshimit	13.09.2024 08:49

Aktiviteti Ekonomik:

Hartimi i projektit detal për rregullimin e infrastrukturës si dhe renovimin e objektit të Stacioni i Autobusave në Prizren.

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave – pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Bajram Fazliu - 1940



Përfaqësuesi i të siguarit
Valon Elshani